



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA BULQIZE

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email.bashkia.bulqize@bulqize.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Bulqizë më 15.10.2021

Drejtuar: Operatorit ekonomik "NEAL-86" me Adrese: Vlore Sarande SARANDE LAGJA 4. me NIPT K04814851T.

Procedura e prokurimit/lotit: **Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Gjoricë dhe ambulancave në fshatrat Dushaj, Gjuras, Peladhi, dhe Çerenec i poshtëm.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-01795-07-27-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Gjoricë dhe ambulancave në fshatrat Dushaj, Gjuras, Peladhi, dhe Çerenec i poshtëm**, Kohezgjatja e kontrates: 2 Muaj nga momenti i neshkrimit te kontates.

Publikimet e mëparshme: nuk ka:

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 117 datë 2 Gusht 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. SELAMI Me Nipt: J77304706L

Vlera: 9 820 816 (nëntë milion e tetëqind e njëzet mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë PA TVSH

2. BOE:RADIKA&FLORIDA

- RADIKA me NIPT: J77304705D
- FLORIDA me NIPT: J79602604P

Vlera: 8 737 496 (tetë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë PA TVSH .

3. ALB-KON ME NIPT: K06626411C.

Vlera: 9 046 930 (nënte milion e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë PA TVSH

4. NEAL-86 ME NIPT: K04814851T

Vlera: 9 715 011 (nëntë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëmbëdhjetë) lekë PA TVSH.

5. ELDA-VL ME NIPT: k 67106202W

Nuk ka paraqitur oferte.

Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.NEAL-86 ME NIPT: K04814851T

Vlera: 9 715 011 (nëntë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëmbëdhjetë) lekë PA TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. SELAMI Me Nipt: J77304706L

Vlera: 9 820 816 (nëntë milion e tetëqind e njëzet mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë PA TVSH

2.BOE:RADIKA&FLORIDA

- RADIKA me NIPT: J77304705D
- FLORIDA me NIPT:J79602604P

Vlera: 8 737 496 (tetë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë PA TVSH .

3. ALB-KON ME NIPT: K06626411C.

Vlera: 9 046 930 (nente milion e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë PA TVSH

4. ELDA-VL ME NIPT: k 67106202W

Nuk ka paraqitur oferte.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

SELAMI:

Operatori ekonomik SELAMI në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për këtë procedurë prokurimi dorëzuar në datën 29.09.2021 : Në seksionin C “Për disponimin e mjeteve/ Pajisjeve/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt Kontrate , ka deklaruar mjetet si më Poshtë:

Kamion me targë AA338 GS, Kamionçinë me targë AA552 BP , Kamionçinë me targë AA553 BP.

Operatori ekonomik SELAMI ka nënshkruar kontratën me Autoritetin Kontraktor Bashkia Bulqizë Nr. 4759 prot. datë: 29.09.2021 me objekt: Rikonstruksion I Godinave në Pronësi të NJVV për Strehim social. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se mjetet e mësipërme janë deklaruar nga operatori ekonomik për realizimin e kësaj procedure prokurimi, rrjedhimisht këto mjete nuk mund të vihen në dispozicion për zbatimin e kontratës, pasi janë të angazhuara në një tjetër Objekt.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk ka mjetet e kërkuara për realizimin e kontratës objekt prokurimi pasi mjetet rezultojnë të angazhuara në një tjetër objekt.

Mbështetur në ligjin 162/2020 neni 76 pika 2, I cili detyron autoritetin kontraktor për skualifikimin e ofertave në rast se operatori ekonomik rezulton me detyrime tatimore.

Si rrjedhojë Autoriteti kontraktor bëri verifikimet në sistem, dhe në bazë të vërtetimit Nr T04748560 datë 29.09.2021 (ditën e hapjes së ofertave), operatori ekonomik Selami rezulton me detyrime tatimore të papaguara.

BOE:RADIKA&FLORIDA

Operatori ekonomik RADIKA ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me operatorin ekonomik FLORIDA, ku dhe ka ndarë zërat e punimeve që do të kryhen nga secili operator.

Mbështetur në Vkm Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 88 pika 1 citon: Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Nga verifikimi I preventivit të dorëzuar në sistem rezulton se: Në preventivin e Rikonstruksion I Ambulances çerenc i poshtëm , Nr.9 Punime sistemimi dhe rrethimi, Zëri: Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka sipas kontratës së bashkëpunimit këto punime janë marrë përsipër nga operatori ekonomik Radika, nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik Radika rezulton se nuk ka punonjës pllakashtrues. Gjithashtu edhe në preventivin e objektit: Rikonstruksion I ambulancës Gjuras, 9 Punime sistemimi dhe rrethimi, Zëri: Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka, këto punime janë marrë përsipër të realizohen nga operatori ekonomik Radika i cili nuk ka deklaruar punonjës pllakashtrues.

Në preventivin e Ambulancës Dushaj Punime suvatimi e bojatisje të brendshme: zëri preventivit: Bojë hidroplastike importi cilesi e I-re, sipas ndarjes së punimeve janë parashikuar të realizohen nga operatori ekonomik Radika, nga verifikimi I formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se Operatori ekonomik Radika nuk ka deklaruar punonjës Bojaxhi për realizimin e këtij procesi pune.

Në preventivin e objektit :Rikonstruksion i Ambulancës Cerenc I poshtëm Nr.9 Gjermim dheu, eskavator me goma, kova 0.25 m3 shkarkim auto, sipas ndarjes së punimeve janë parashikuar të realizohen nga operatori ekonomik Florida, I cili në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin: Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, rezulton se operatori ekonomik nuk ka Deklaruar mjet për gjermime, rrjedhimisht operatori ekonomik nuk ka mjetet e nevojshme për realizimin e këtij procesi pune.

Nga verifikimi në sistemin e-albania sipas vërtetimit Nr. T04749130 datë, 29.03.2021 rezulton se operatori ekonomik Florida ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në vlerën 12 334 lekë për të paguar.

Gjithashtu Operatori ekonomik RADIKA në bazë të vërtetimit ëe gjeneruar nga sistemi e- Albania Nr.04748540 datë 29.09.2021 rezulton me detyrime të papaguara në datën 29.09.2021.

ALB KON:

Në dokumentet standarte të tenderit është kërkuar: Teknik Topograf 1(një)) për këtë duhet të paraqesë Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik nuk ka deklaruar se ka të punësuar teknikun Topograf. Në dokumentet standarte të tenderit është kërkuar:

•Hidroizolues 2(dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë ne listëpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik ka deklaruar Z, Afrim POCI me profesion hidroizolues. Nga verifikimi i listëpagesave të dorëzuara nga operatori ekonomik në sistem rezulton se punonjësi i sipërcituar nuk figuron i punësuar pranë kësaj shoqërie.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk ka numrin e kërkuar të hidroizoluesve.

Në dokumentet standarte të tenderit është vendosur kriteri i mëposhtëm:

Bojaxhi 2(dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik ka deklaruar Z.Gentian Losha me profesion Bojaxhi. Nga verifikimi i listëpagesës së paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se punonjesi i sipërcituar është siguruar vetëm me dy ditë pune në muajin Qershor, për muajin korrik dhe Gusht, nuk figuron në listëpagesë

Sa më sipër kjo pikë nuk plotësohet nga operatori ekonomik.

Perveç këtyre mangësive të sipërcituara, në baze të listëpagesës së dorëzuar nga operatori ekonomik, një pjesë e konsiderueshme e punonjësve rezultojnë të siguruar me 2 ditë pune, cka perben shkelje për detyrimet kontraktuale të punës, punëdhënës-punëmarrës

Në bazë të vërtetimit Nr.T 04748504 datë 29.09.2021 operatori ekonomik rezulton me detyrime tatimore të papaguara.

ELDA-VL me NIPT: K67106202W

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë NEAL-86 me Adrese: Vlore Sarande SARANDE LAGJA 4, se oferta e paraqitur me vlerë totale: 9 715 011 (nëntë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëmbëdhjetë) lekë PA TVSH. është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, ‘Për Prokurimin Publik’

ZYRTARI I AUTORIZUAR
ENKELEDA LLESHI